

GRAMATIKA DEPENDENCIALE, ZBATIMI I SAJ TE GJYMTYRËT E FJALISË NË GJUHËN SHQIPE - VALENCA

Muarem AJDARI¹, Osman ISMAILI²

¹ Department of German Language and Literature, Faculty of Philology, University of Tetova

² Department of German Language and Literature, Faculty of Philology, University of Tetova

*Corresponding author e-mail: muarem.ajdari@unite.edu.mk, osman.ismaili@unite.edu.mk

Abstract

For the parts of the sentence, as they are treated by traditional grammars, both in the German language and in the Albanian language, their hierarchy in the sentence is not clearly given. Dependency grammar enables a more precise definition of the structure of the sentence based on the hierarchy of its component parts. The grammar of Ulrich Engel (Engel, 2009), which is based on the syntactic structure of Lucian Tenier (Lucien Tesnière), gives a clearer picture of the position of the parts in the sentence. In fact, Ulrich Engel defines the sentence as a linguistic construction that contains a verb in an elaborate form, which is not subordinated to any other element.

And this means that the verb is the head of the sentence, as far as the hierarchy in the sentence is concerned. Exactly the verb is the element that determines the structure of the sentence. In the sentence *Er studiert die deutsche Sprache* ('Ai studion gjuhën gjermane') the verb *studieren* requires a subject (Subjekt) and an accusative complement (Akkusativergänzung). The construction of the sentence is determined by the verb as the head of the sentence. The object of this paper is the dependence in the syntactic constructions, which will reach the determination of the members in the sentence, the obligatory and the optional members. It will be treated according to the model in the German language and define how this can be applied to the Albanian language.

Keywords: *Dependency, head, regent, dependent, phrases, complement, adverbial determinations.*

Përmbledhje

Për gjymtyrët e fjalisë, ashtu siç trajtohen nga gramatikat tradicionale, si në gjuhën gjermane ashtu edhe në gjuhën shqipe nuk jepet qartë hierarkia e tyre në fjali. Gramatika e varësisë mundëson një përcaktim më saktë të strukturës së fjalisë në bazë të hierarkisë të pjesëve të saj përbërëse. Gramatika e Ulrich Engel (Engel, 2009), e cili bazohet te struktura sintaksore e Lucian Tenier (Lucien Tesnière) e jep një pasqyrë më të qartë të pozitës së gjymtyrëve në fjali. Në fakt Ulrich Engel e përkufizon fjalinë si një konstruksion gjuhësor që përmban folje në formë të shtjelluar, e cila nuk është e nënshtruar ndaj ndonjë elementi tjetër.

Dhe kjo do të thotë se folja është koka e fjalisë, sa i përket hierarkisë në fjali. Pikërisht folja është elementi që e përcakton edhe strukturën e fjalisë. Në fjalinë *Er studiert die deutsche Sprache* ('Ai studion gjuhën gjermane') folja *studieren* kërkon të ketë një subjekt (Subjekt) dhe një plotësor në kallëzore (Akkusativergänzung). Konstruksionin e fjalisë e përcakton folja si **kokë** e fjalisë. Objekt i këtij punimi është varësia në konstruksionet sintaksore, me çka do të arrihet deri te përcaktimi i gjymtyrëve në fjali, të gjymtyrëve obligative dhe atyre fakultative. Do të trajtohet sipas modelit në gjuhën gjermane dhe të definohet se si mund të zbatohet kjo te gjuha shqipe.

Fjalët kyçe: *Dependenca, varësia, kokë, regens, dependens, sintagmë, plotësor, rrethanor.*

Hyrje

Gjatë mësimit të një gjuhe të huaj në mënyrë analoge shërben sistemi i gjuhës amtare, në rastin tanë sistemi i gjuhës shqipe. Gjatë diskursit përdoren fjali, të cilat kanë një renditje të caktuar të gjymtyrëve të tyre në gjuhën gjermane, e që nuk përkon çdoherë me renditjen apo strukturën e fjalisë në gjuhën shqipe, kur kërkohet ekuivalenti i një fjalie të dhënë të gjuhës gjermane. Gramatika dependenciale mund të pasqyrojë qartë strukturën sintaksore dhe varësinë e elementeve në fjali. Ajo nisat nga folja si kokë e fjalisë, nga e cila varen gjymtyrët e fjalisë, por sqaron edhe varësinë e elementeve brenda gjymtyrëve. Në fakt folja do të jetë elementi kryesor që përcakton se çfarë elementesh do të ketë në një fjali. Kështu ajo i përcakton gjymtyrët obligative të fjalisë, pa të cilat fjalia nuk do të ishte gramatikisht korrekte.

1. Dependencia

Gramatika dependenciale (gramatika e varësisë) bazohet në qëndrimin se në konstruksionet gjuhësore ekziston një varësi e ndërsjellë e fjalëve/fjalëformave. Dependencia përcaktohet në bazë të nivelit të paraqitjes së fjalëve në fjali: nëse paraqitet një element (një fjalë apo fjalëformë), atëherë mundet apo patjetër të paraqitet një element tjetër (një fjalë apo fjalëformë). Kështu, për shembull, nëse paraqitet një emër (*Tisch* 'tavolinë'), atëherë mund të paraqitet edhe një mbiemër (*rund* 'i/e rrumbullakët'), e që është një dependencë fakultative. Mirëpo, nëse shfaqet një parafjalë (*bei* 'te/tek'), atëherë patjetër të shfaqet një element tjetër, zakonisht një emër apo përemër (*Peter/mir* 'Peteri/unë (mua)').


Ky shembull e ilustron dependencën obligative. Niveli i shfaqjes nuk ka të bëjë me renditjen e fjalëve, po me strukturimin e konstrukteve gjuhësore. Elementi që për nga pikëpamja strukturore konsiderohet si „primar“, është element kryesor, gjegjësisht element që drejton (udhëheq) dhe quhet **regens** (Regens). Elementi, shfaqja e të cilit është e kushtëzuar nga regensi është elementi i drejtuar (i udhëhequr) dhe quhet **dependens** (Dependens). Çdo dependens mund të ketë vetëm një regens, ndërsa një regens mund të ketë më tepër dependensë (Engel 1996: 21).

Gramatikani ka një liri të caktuar për të përcaktuar cili element është regens e cili dependens, që nuk do të thotë se hiqet domosdoshmëria e argumentimit të zgjidhjes. Tek dependencia fakultative, sipas Engel, regens është elementi obligativ (për shembull, emri), ndërsa ai fakultativ është dependens (mbiemri). Tek dependencia obligative, Engel udhëhiqet pjesërisht nga kriteri morfologjik (i fleksionit). Kështu, për shembull, në konstruksionet e llojit *bei meiner Freundin* ('te shoqja ime') parafjala përcaktohet si regens, pasi që ajo e detyron emrin/mbiemrin në një rasë të caktuar.


Nëse një konstruksion gjuhësor analizohet pavarësisht nga rrethina e tij, elementi që zë vendin më të lartë hierarkik dhe nga i cili varen elementet tjera ka një rëndësi apo domethënie të veçantë. Ky element i brendshëm drejtues quhet **kokë** (Kopf). Koka e karakterizon konstruksionin gjuhësor, e cili edhe mund ta bartë emrin e tij (këtij konstruksioni). Konstruksionet e emërtuara sipas kokës quhen **sintagma** (Phrasen). Kështu, për shembull, konstruksioni *das Buch* ('libri') është sintagmë emërore, pasi që ka një emër si kokë, ndërsa shprehja *auf den Tisch* 'në/mbi tavolinë' është sintagmë parafjalore, pasi që koka e saj është parafjalë.

Në fjalinë *Dort saßen sie an einem kleinen Tische mit runder Platte* (Tërles, gjerm.: 31; ('Aty po rrinin ulur në një tryezë të vogël me pllakë rrumbullake'); M. A.), *saßen* ('rrinin ulur') është koka, që do të thotë se kjo fjali është sintagmë foljore. Konstruksioni gjuhësor mund të varet nga një element tjetër, që është jashtë tij, pra që nuk është pjesë përbërëse e atij konstruksioni gjuhësor. Ky element i jashtëm drejtues quhet **regens i jashtëm** apo thjeshtë **regens** (Regens). Konstruksionet e emërtuara sipas regensit janë **gjymtyrë (segmente) sintaksore** (syntaktische Glieder).

Në fjalinë e lartpërmendur, parafjala *an* është regens i sintagmës emërore *einem kleinen Tische mit runder Platte* 'tryezë e vogël me pllakë rrumbullake', që do të thotë se ky konstruksion është segment i parafjalës.



Nëse për hulumtimin e dhënë, nuk është me rëndësi se çfarë lloj sintagme është konstruksioni gjuhësor, atëherë thjeshtë flitet për një **grup fjalësh** ose togfjalësh (Wortgruppe). Në disa hulumtime nuk luan rol të rëndësishëm struktura e brendshme e grupit të fjalëve, respektivisht nuk është me rëndësi se si janë të shpërndarë dependensët. Në atë rast, tërësia e dependensëve shqyrtohen si tërësi dhe quhet **satelit** (Satellit). Çdo fjalë që mund të ketë satelitë është në gjendje të krijojë sintagmë (Engel 1991: 22). Gjatë paraqitjes së satelitit nuk paraqitet struktura e brendshme dependenciale e konstruksionit gjuhësor. Në diagramin që pason, sintagma emërore është e paraqitur si satelit.



Satelitët klasifikohen sipas regensit. Nëse regensi është folje, respektivisht nëse bëhet fjalë për satelit/gjymtyrë (segment) të foljes, atëherë ai/ajo quhet **gjymtyrë e fjalisë** (Satzglied). Nëse regensi bie në një grup tjetër fjalësh, atëherë ai satelit është **atribut** (Attribut). Në fjalinë e mësipërme, ka tri gjymtyrë të fjalisë: ndajfolja *dort*, përemri *sie* dhe sintagma parafjalore *an einem kleinen Tische mit runder Platte*. Sintagma emërore *einem kleinen Tische mit runder Platte* është atribut i parafjalës *an*, ndërsa sintagma parafjalore *mit runder Platte* është atribut i emrit *Tisch*.

2. Struktura e fjalisë

Fjalìa (Satz) është konstruktion gjuhësor që përmban folje në formë të shtjelluar si kokë, e cila nuk është e nënshtruar ndaj ndonjë elementi tjetër, prandaj (të paktën potencialisht) është autonome. Folja e përcakton strukturën e fjalisë (Engel 1994: 141). Fjalitë e nënrenditura, sipas Engel, nuk janë fjali në kuptim të definicionit të dhënë më lart, sepse i nënshtrohen fjalisë kryesore. Kokë e fjalisë nënrenditëse është elementi subjunktiv (nënrenditës) *dass, wenn, weil* dhe subjunkcione të tjera, për shembull: *Er sagt, dass er sofort kommt* ('Ai thotë se do të vijë menjëherë') – (Engel 1994: 145).

Nocioni i përgjithshëm për fjalitë dhe fjalitë e varura është konstruktion fjalie (Satzartige Konstruktion). Nëse konstrukcioni i fjalisë përmban më tepër forma foljore, atëherë bëhet fjalë për **kompleks foljor**. Ai mund të përbëhet nga dy, tre apo katër forma foljore, me ç'rast folja kryesore drejtohet nga elementet tjera të kompleksit foljor. Në diagramin e kompleksit foljor nuk ka degëzime.

(1) <i>Thomas hat ein Buch gekauft.</i>	<i>Tomasi e ka blerë një libër.</i>
(2) <i>Er muss ein Buch kaufen.</i>	<i>Duhet të blejë një libër</i>
(3) <i>Diese Frage ist geklärt worden.</i>	<i>Kjo çështje është e sqaruar</i>
(4) <i>Diese Frage muss geklärt werden.</i>	<i>Kjo çështje patjetër të sqarohet.</i>
(5) <i>Diese Frage soll geklärt worden sein.</i>	<i>Kjo çështje duhet të jetë sqaruar.</i>

Folja ndihmëse dhe foljet modale kërkojnë formën e pashtjelluar foljore.



Forma e shtjelluar foljore (folja modale apo ndihmëse) gjithmonë e zë vendin më të lartë hierarkik, ndërsa në mënyrë të drejtpërdrejtë apo jo të drejtpërdrejtë nga ajo varet folja kryesore.

3. Valenca e foljes

Gjymtyrët (segmentet) e fjalisë janë satelitë të foljes (varen drejtpërdrejtë nga folja) dhe janë në raport paradigmatic, gjegjësisht mund të zëvendësohen me elemente të tjera, më saktë, me të paktën një element:


<i>Mir gefällt das Buch.</i>	'Libri më pëlqen.'
Mir gefällt es.	'(Ai) Më pëlqen.'

Në fjalinë *Es regnet den ganzen Tag* ('Tërë ditën bie shi'), përemri *es* nuk është gjymtyrë e fjalisë, pasi që nuk mund të zëvendësohet me një element tjetër. Gjymtyrët e fjalisë ndahen në dy nëngrupe: **plotësorë** (Ergänzungen) dhe **rrethanorë** (freie Angaben). Ndarja bëhet sipas kriterëve specifikim dhe domosdoshmëri. Për tu përcaktuar një gjymtyrë e fjalisë si plotësor, duhet të përmbush të paktën një kriter. Një gjymtyrë e fjalisë konsiderohet se është specifike, nëse shfaqet vetëm tek një nënklasë e caktuar e foljeve (tek nënklasa të caktuara) dhe në atë rast paraqet plotësor, pa marrë parasysh se e përmbush apo jo kriterin e domosdoshmërisë. Gjymtyra jo specifike e fjalisë (pra ajo që kombinohet me cilëndo folje) patjetër t'i nënshtrohet kriterit të dytë për tu përcaktuar statusi i saj. Nëse është e domosdoshme (respektivisht, nëse pa të fjalìa është gramatikisht jo korrekte), atëherë edhe ajo gjymtyrë e fjalisë është plotësor.

Nëse gjymtyra jo specifike e fjalisë është fakultative (nëse edhe pa të fjalia është gramatikisht korrekte), atëherë ajo nuk e përmbush asnjë kriter dhe përcaktohet si rrethanor. Sipas kësaj, plotësorët mund të jenë specifikë dhe të domosdoshëm, specifikë dhe fakultativë ose jo specifikë por të domosdoshëm, ndërsa rrethanorët janë jo specifikë dhe fakultativë. Lidhur me rrethanorët, sipas Ulrich Engel, konsiderohet se çdo klasë e rrethanorëve të fjalisë mund të kalojë tek plotësorët nëse është e domosdoshme, pa marrë parasysh se a është e shënuar ashtu në mënyrë eksplicite në versionin e zbatuar të gramatikës së Ulrich Engel nga viti 1996.


Specifikimi ka të bëjë me tërë klasën e gjymtyrëve të fjalisë (psh. plotësori në kallëzore është specifik, pasi që ekzistojnë folje që nuk e lejojnë atë), ndërsa domosdoshmëria përcaktohet për çdo folje veçmas (psh. plotësori në kallëzore është pjesërisht i domosdoshëm, dhe pjesërisht fakultativ, respektivisht tek disa folje është i domosdoshëm, ndërsa me disa folje është fakultativ). Fjalia *Thomas ißt Pizza* ('Tomas ha picë') edhe pa plotësorin në kallëzore *Pizza* është gramatikisht korrekte. Në këtë rast plotësori në kallëzore e përmbush vetëm kriterin e specifikimit, por jo edhe të domosdoshmërisë. Në fjalinë *Er hat Geld* ('Ai ka para') nuk mund të hiqet plotësori në kallëzore *Geld*, pasi që është i domosdoshëm. Aftësia e foljes të kërkojë plotësorë, me të cilat e përcakton strukturën e fjalisë quhet **valencë** (Valenz).

Shembull:




Folja *spielen* kërkon vetëm një plotësor të domosdoshëm, edhe atë subjektin (kryefjalën) (*ich*).

- (2) *Ich wohne in Berlin.* *Unë banoj në Berlin.*
(3) *Das Buch liegt auf dem Tisch.* *Libri është mbi tavolinë.*



Foljet në (2) dhe (3) kërkojnë dy plotësorë obligativ, subjektin *ich/das Buch* dhe plotësorin situativ *in Berlin/auf dem Tisch*.

1. *Ich lege das Buch auf den Tisch.* (Unë) e vë librin mbi tavolinë.



Folja *legen* kërkon tre plotësorë obligativ: subjektin (*ich*), plotësorin në kallëzore (*das Buch*) dhe plotësorin e drejtimit (*auf den Tisch*). Këto shembuj dhe diagrame e ilustrjnë qëndrimin se folja është koka e fjalisë, respektivisht se ajo e merr pozicionin më të lartë të hierarkisë në strukturën e fjalisë. Kjo veçori e përcakton gramatikën e Ulrich Engel si gramatikë foljore. Në këtë mënyrë subjekti e humb pozitën „e privilegjuar“ edhe pse harmonizohet me formën foljore për nga veta dhe numri. Për Engel, harmonizimi mes formës foljore dhe subjektit për nga veta dhe numri nuk ka domethënie vendimtare për strukturën e fjalisë, pasi që ai ka karakter vetëm sipërfaqësor, formal, por jo edhe strukturor.

Përfundim

Për të gjetur kuptimin e një konstruksioni gjuhësor të thënë në gjuhën gjermane, e veçanërisht ekuivalentin e duhur të atij konstruksioni në gjuhën shqipe, më së miri është që të vihet re së pari hierarkia apo varësia e konstruksioneve të tilla në fjali, apo edhe e vet elementeve të një konstruksioni të tillë gjuhësor. Gramatika dependenciale e pasqyron qartë strukturën dhe varësinë e elementeve në fjali. Ajo bazohet në qëndrimin se në konstruksionet gjuhësore ekziston një varësi e ndërsjellë e fjalëve apo fjalëformave. Dependenca përcaktohet në bazë të nivelit të paraqitjes së fjalëve në fjali.

Nëse paraqitet një element, atëherë është patjetër apo është e mundur të paraqitet një element tjetër. Kjo ka të bëjë me elementet obligative apo fakultative të një fjalie. Elementi primar është element që udhëheq dhe quhet **regens**. Elementi që është i kushtëzuar nga reagensi quhet **dependens**. Elementi që zë vendin më të lartë hierarkik dhe nga i cili varen elementet tjera është element drejtues dhe quhet **kokë** (Kopf). Konstruksioni gjuhësor emërtohet sipas kokës së tij dhe quhen **sintagma** (Phrasen). Ato janë **gjymtyrë** (segmente) **sintaksore** apo gjymtyrë të fjalisë.

Gjymtyrët e fjalisë varen drejtpërdrejtë nga folja dhe janë në raport paradigmatic, gjegjësisht mund të zëvendësohen me elemente të tjera, më saktë, me të paktën një element:

<i>Mir gefällt das Buch.</i>	‘Libri më pëlqen.’
Mir gefällt es.	‘(Ai) Më pëlqen.’

Ato ndahen në dy nëngrupe:

- Plotësorë
- Rrethanorë

Referencat

- [1]. Agalliu, F., Angoni, E., Demiraj, S., Dhrimo, A., Hysa, E., Lafë, E., & Likaj, E. (2002). *Gramatika e gjuhës shqipe I* (Vëll. i 1). Tiranë: Akademia e shkencave e Shqipërisë.
- [2]. Buchholz, O., & Fiedler, W. (1987). *Albanische Grammatik*. Leipzig: VEB Verlag Enzyklopädie.
- [3]. Bußmann, H. (2002). *Lexikon der Sprachwissenschaft*. Stuttgart: Kröner.
- [4]. Çeliku, M., Domi, M., Floqi, S., Mansaku, S., Përnaska, R., Prifti, S., & Totoni, M. (2002). *Gramatika e gjuhës shqipe II* (Vëll. i 2). Tiranë: Akademia e shkencave e Shqipërisë.
- [5]. Demiraj, S. (1987). *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*. Prishtinë: Rilindja.
- [6]. Duden. (2003). *Deutsches Universalwörterbuch* (bot. i 5). (Dudenredaktion, Re.) Mannheim: Dudenverlag.
- [7]. Duden. (2006). *Die Grammatik* (bot. i 7, Vëll. i 4). Mannheim: Bibliographisches Institut & F.A. Brockhaus AG Mannheim.
- [8]. Eisenberg, P. (2004). *Grundriß der deutschen Grammatik* (Vëll. i 2). Stuttgart: Metzler.
- [9]. Engel, U. (1992). Der Satz und seine Bausteine. Në V. Agel, R. Hessky, V. Agel, & R. Hessky (Red.), *Offene Fragen - offene Antworten in der Sprachgermanistik* (fv. 53-76). Tübingen: Max Niemeyer Verlag.
- [10]. Engel, U. (1994). *Syntax der deutschen Gegenwartssprache*. Berlin: Schmidt.
- [11]. Engel, U. (1996). *Deutsche Grammatik* (bot. i 3., korrigierte Auflage). Heidelberg: Julius Groos Verlag.
- [12]. Engel, U. (2009). *Deutsche Grammatik - Neubearbeitung* (bot. i 2). München: IUDICIUM Verlag.
- [13]. Engel, U., & Schumacher, H. (2003). *Kleines Valenzlexikon deutscher Verben*. Mannheim: Institut für deutsche Sprache.
- [14]. Eroms, H. (2000). *Syntax der deutschen Sprache*. Berlin/New York: de Gruyter.

- [15]. Hahn, J. (1854). *Albanesische Studien*. Jena: Mauke.
- [16]. Helbig, G., & Buscha, J. (2013). *Deutsche Grammatik*. München: Klett-Langenscheidt.
- [17]. Heringer, H.-J. (1996). *Deutsche Syntax dependenziell*. Tübingen: Stauffenburg.
- [18]. Rein, K. (1983). *Einführung in die kontrastive Linguistik*. Darmstadt: Wissenschaftliche Buchgesellschaft.
- [19]. Schulz, D., & Griesbach, H. (1970). *Grammatik der deutschen Sprache*. München: Max Hueber Verlag.
- [20]. Simoni, Z. (1978). *Fjalor gjermanisht - shqip*. Tiranë: 8 Nëntori.
- [21]. Sternemann, R. (1983). *Einführung in die kontrastive Linguistik*. Leipzig: Veb.
- [22]. Zifonun, G., Hoffmann, L., & Strecker, B. (1997). *Grammatik der deutschen Sprache*. Berlin: de Gruyter.